

NO SITI

E përjavshme Informativ (Nr. 457) 2 - 15 Mars 2009 Çmimi 20 Lekë

Shtypshkronja
D.I.J.A.-Poradeci
Tel: 003558322905
Mobil: 00355682158284



Ka vendime që ulin imazhin e gjykatës

Analiza vjetore e Gjykatës së rrethit gjyqësor Pogradec



Intervista

Spitalet dhe maternitetet drejt mekanizmit të ri të vetëmenaxhimit



Intervistë me zotin Refki Pere, shefi i departit të obstetrikë-gjinekologjisë në Maternitetin e Pogradecit

Lexoni në faqen 4

Aktualitet

“KARNAVALET e Korçës” në Çikago



Kush mori pjesë në mbremjen e artit, organizuar nga stafi i revistës “Rreth Nesh” në bashkëpunim me Aleancën Shqiptare Amerikane, më 2 nëntor të vitit të kaluar, padyshim ka fiksuar në kujtesë momentet që u sollën nga filmimet e kryera gjatë provave për vënien në skenë të komedisë së Spiro Çomorës “Karnavalet e Korçës”.

Lexoni në faqen 5

Suplement "Unë, Gruaja"



Nga Afroviti Gusho

Të parat e klasës...

A kemi ne një model për gratë politike

Lexoni në faqet 7-10

Kosova

10 vjet më parë Toka shqiptare



Lexoni në faqen 9



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Bashkia Pogradec
Ndërmarrja e Taksa-Tregjeve

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë bizneset në bazë të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore të gjitha subjektet e biznesit të vogël të regjistruhen në Ndërmarrjen e Taksa-Tregjeve Bashkia Pogradec deri në datën 20.03.2009. Mbas kësaj date do të ketë penalitete.

BANKA POPULLORE
SOCIETE GENERALE GROUP

5 vjet
së bashku
2004-2009

www.bpopullore.com



Bashkia dhuratë taksa më të larta

Korçë

Me 400 lekë më të larta do të jenë taksat e vendosura nga Bashkia e Korçës për familjarët këtë vit të ri ushtrimor. Kjo rritje është miratuar nga Këshilli i Bashkisë dhe është mbrojtur nga ana e Bashkisë se do të rriten sipërfaqet e gjelbëruara dhe ato të

pastrimit e ndriçimit. Në kuadrin e rritjes së nivelit të çmimeve dhe Bashkia ka menduar që të mos mbetet mbrapa në rëndimin e buxhetit familjar.

Që prej një viti tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit Bashkia e Korçës i vjel nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm

LIBONIK

250 milion lekë investime për një orë ujë kënetete

Komuna e Libonikut është nga më të mëdhatë në qarkun e Korçës. Ajo përbëhet nga fshatrat që përbënin ish NRGJ-në. Vite më parë ka patur një nivel të lartë jetese dhe një infrastrukturë të mirë nëpër fshatra, e cila u shkatërrua gjatë viteve të tranzicionit. Kjo komunë është qeverisur vetëm nga socialistët deri tani dhe asnjë kandidat për kryetar komune nga PD-ja apo parti tjetër e djathtë nuk ka mundur dot që të dalë fitues.

Për ujësjellësat e fshatrave janë shpenzuar

miliona lekë, por banorët nuk kanë më shumë se një orë ujë në ditë. Ky ujë nxirret me pompa nga kënetat dhe nuk i ka parametrat të mira për t'u pirë. Vetëm për fshatin Libonik që është dhe qendra e komunës janë shpenzuar 250 milion lekë të vjetra për ujësjellësin. Banorët shprehen të pakënaqur nga ky investim jo dobiprurës për ta. Mbi kodrat e fshatit ka plot burime që mund të përdoren për të furnizuar banorët me ujë. Por u zgjodh shpimi në ish kënetën e Maliqit për të nxjerrë burime uji. Banorëve iu premtua

që do të kishin 24 orë ujë pa ndërprerje. Shqetësim tjetër për banorët e këtij fshati është edhe gjendja e keqe e rrugëve. Fshati ka 12 rrugë dhe vetëm një çerek rruge është rregulluar. Ndër vite atyre u është premtuar se do të sistemohen të 12 rrugët dhe ujësjellësi do të shtojë kapacitetin duke i furnizuar me ujë 24 orë. Gjendjen e ka bërë prezent gjatë një takimi në fshatin Libonik me kreun e LSI-së Ilir Metën, kryetari i kësaj partie Vilson Agolli. Ai u shpreh: "Qeverisja socialiste ka dështuar në komunën e Libonikut."

KOLONJË

Dhunohen varret

-Vidhen 40 vazo bronzi për skrap

Fenomeni i dhunimit të varreve është shfaqur edhe në qytetin e Ersekës ku janë përvetësuar 40 vazo bronzi që ishin vënë nga të afërmit në varret e të ikurve të tyre si mjete zbukurimi. Policia është vënë në kërkim të gjetjes së autorëve të këtij dëmi. Ky fenomen është shfaqur kohë më parë në varret e fshatrave të Korçës dhe tani së fundi ka përfshirë dhe varrezën publike të

qytetit të Ersekës. I vetmi funksion i këtyre vazove pas shkuljes nga varret është shitja e tyre për skrap, kundrejt një fitimi. Por dëmi që i shkakton varrezës publike është tepër i madh se e shëmton atë. Banorët, në përpjekje për t'i zëvendësuar janë të shqetësuar se përsëri mund të ndodhë i njëjti fenomen që nuk ka qenë i përhapur në qytetin e Ersekës.

Fond për restaurimin e shtëpisë muze të piktorit Vangjush Mio

Korçë/ Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio do të restaurohet me një fond prej 4 milion lekësh, që buxheti i shtetit i ka dhënë nëpërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Restaurimi do të nisë ditët e para të muajit mars. Do të bëhet riparimi

i çatisë, rregullimi i kalldrimit të oborrit, riparime dyersh e dritaresh si dhe suvatime të jashtme. Restaurimi i parë i kësaj shtëpie është bërë në vitin 1990. Shtëpia e piktorit Vangjush Mio është shpallur Monument kulture në vitin 1977.

LESKOVIK

Të rinjtë me thika

Sherri mes dy të rinjve në qytetin e Leskovikut, ka vënë në përdorim thikat, ku nga përleshja të dy mbetën të gjakosur. Mihal Fidhe 25 vjeç, pas një konflikti për motive të dobëta me Edison Shqipen, e ka goditur me thikë, duke i shkakuar plagë më të rënda, ndërsa vetë është plagosur lehtë. Pas këtij dyluftimi, Edisoni u dërgua në spitalin e Përmetit, ndërsa Fidhe në paraburgim.

Kapet me fishekë

Korçë/ Forcat e policisë së Korçës kanë arrestuar shtetasin Genti Hoxhallari, banues në fshatin Pirc, pasi e kanë kapur në flagrancë me mbajtje fishekësh. Ai akuzohet për veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve" parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal. Sipas policisë fishekët i janë dhënë një nxënësi shkolle, por ai ka dëshmuar se ia kishte dorëzuar Hoxhallarit. Në banesën e Genti Hoxhallarit u gjendën 130 copë fishekë pistolete.

Analiza vjetore e Gjykatës së rrethit gjyqësor Pogradec

Nën kryetari i Këshillit të lartë të Drejtësisë, Kreshnik Spahiu ka marrë pjesë në analizën e gjykatës së faktit Pogradec.

"Ne kemi marrë pjesë në analizat e disa gjykatave. Kjo është një mundësi e mirë për të njohur çdo gjyqtar, për të njohur mendimin e tyre juridik. Në gjykata të ndryshme ka specifika të ndryshme". E hapi kështu analizën vjetore të gjykatës së Pogradecit Spahiu. "Kështu informohemi me karakteristikat e çdo rrethi gjyqësor." Spahiu parashitri kërkesat e përsëritura dhe në gjykata të tjera si: ngarkesa e çështjeve që gjykohen, shpejtësia e gjykimit dhe cilësia e tij dhe transparanca në vendimmarrje.

"Në Tiranë ka probleme me përgjimet e telefonave. Numra anonimë pa gjeneralitete. Në Durrës është problem kalimi i paligjshëm i kufirit. Në Fier proceset e privatizimit. Ne kërkojmë që të dalë vlerësimi për çdo gjyqtar. Ka vendime që ulin imazhin dhe hedhin hije dyshimi në këto vendimmarrje, - u shpreh më tej ai. Ka dhe raste që devijojnë nga standarti tek fenomeni." Ai u kërkoi gjyqtarëve të Pogradecit që të japin mendime dhe ide konkrete.

Spahiu përmendi faktin se gjykata e Pogradecit ka probleme me infrastrukturën. Është e varfër dhe nuk lejon që gjyqtarët e Pogradecit të punojnë në kushte normale. "Janë kushte mjerane të ambienteve të kësaj gjykate që këtë vit do të ndryshojnë. Por ka dhe gjyqtarë që udhëtojnë për orë të tëra për të shkuar çdo ditë tek familjet. Dhe ta shikojmë çështjen se sa ata janë në gjendje që pasi kanë gjykuar pesë çështje, a u mbetet kohë e lirë për të studiuar dosjet dhe të japin vendime të drejta." Spahiu theksoi se gjykata e Pogradecit me ardhjen e kryetarit të ri Niko Rapi, ka bërë ndryshime në cilësinë e dhënies së vendimeve dhe fryma e re e kryetarit është reflektuar në rezultatet që ka kjo gjykatë për vitin 2008. Ai theksoi disa herë se në vlerësimin e punës së çdo gjyqtari tre do të jenë parametrat: Shpejtësia në gjykim, volumi i gjykimeve dhe cilësia e tyre.

Niko Rapi, kryetari i gjykatës së Faktit Pogradec, gjatë fjalës së tij u shpreh: "Gjatë vitit 2008 janë gjykuar 1905 çështje, ku për çdo gjyqtar i bie mesatarisht 240 çështje. Nga sasia e çështjeve të gjykuara, 1584 kanë qenë çështje civile dhe 321 penale. Por nuk



Ka vendime që ulin imazhin e gjykatës

Marrin pjesë:

nën kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kryetarja e Gjykatës së Apelit Korçë, kryetari Dhomes së avokatisë Korçë,

Kreshnik Spahiu
Entela Prifti
Raqi Ceta

Analiza u zhvillua në ambientet e hotel "Enkelana"

ka barazi në gjykimin e çështjeve nga gjyqtarët. Dikush ka gjykuar mbi këtë mesatare e dikush nën këtë mesatare. E krahasur me vitin 2007 kemi një rritje të numrit të gjykimit të çështjeve.

Në vitin 2007 u mbyllën 1450 çështje. Për vitin 2008 janë ankmuar 132 çështje dhe 51 prej tyre janë lënë në fuqi nga Apeli. Nuk është cënuar cilësia e gjykimeve. Rreth 20 % e çështjeve të ankmuara janë të cënuara, nga 30% që është kufiri i pranueshëm.

Përgjime telefonike kanë qenë 10 me kërkesë të prokurorisë, të cilat kanë qenë jo me numra anonimë, por me gjeneralitete të përcaktuara. Probleme kemi me paraburgimin pasi vijnë me vonesë dhe prishim oraret e gjyqeve të tjera. Problem kemi patur dhe me sigurinë në gjykatë, nga mungesa e një punonjësi për rregullin e brendshëm, por që tani e kemi zgjidhur. Problem janë dhe adresat e dëshmitarëve, pasi nuk kanë adresa të sakta. Por edhe avokatët shpesh vijnë që nga kafja e në sallë pa e njohur mirë dosjen. Kemi patur shtyrje të seancave, pasi për vetë numrin e kufizuar të gjyqtarëve i ka rënë që të ketë dhënë më parë vendim në lidhje me çështje të rikthyera për gjykim.

Vështirësi ka patur në hetim dhe në ekspertim të çështjeve.

Për periudhën në vazhdim synojmë në ngritjen profesionale të gjyqtarëve nëpërmjet trajnimit të tyre dhe në krijimin e kushteve më të mira materiale. Kemi krijuar një regjistër të veçantë. Nga ana e gjyqtarëve nuk ka patur abuzime. Nga 75 masa arresti me burg janë lënë në fuqi 71. "Masa e arrestit me burg, -u shpreh Spahiu, - është masa më ekstreme. Ka raste që për një vepër jo me rrezikshmëri të lartë shoqërore jepet arresti dhe për një person me rrezikshmëri të lartë lihet ndjekja e lirë. Kjo ndodh sepse gjykata e ka të vështirë që të japë dënim me burg, kur i pandehuri nuk është në masë arresti dhe kur është në masë arresti e ka të vështirë që të japë dënim me gjobë. Ka raste të shpërdorimit të detyrës nga zyrtarët, këta lihen në gjendje të lirë." Spahiu qëndroi tek fenomeni i përgjimeve. Vetëm në Tiranë janë 1300, tha ai.

Prokurorja Elina Zgjani shprehet: "Me përgjimet nuk kemi cënuar lirinë e personit. Përgjimi është bërë me emra konkretë e me të gjitha gjeneralitetet përkatëse. Nuk ka adresa të sakta. Vendimet na janë vënë në dispozicion në kohë për ankimim."

Kurse kryetarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Entela Prifti tha: "Me masat e sigurisë me arrest me burg ka abuzime. Vijnë dosje të paplotësuara e me mangësi. Arrest me burg kërkohet edhe për falsifikim edhe për fyerje për shkak të detyrës. Arresti me burg është një masë e rëndë që jepet. Ligji parashikon masa të tjera sipas shkallës së rrezikshmërisë që paraqet i pandehuri. Formulimi i dosjeve nga të rinjtë bëhet ndryshe dhe ndryshe nga ata me stazh në punë."

Kryetari i Dhomes së Avokatisë së Korçës, Raqi Ceta, u shpreh se përgjimet duhet të reduktohen. "Kam një rast në Korçë kur është përgjuar një person dhe nëpërmjet tij janë përgjuar dhe të tjerë që ai ka folur. Nuk ka një procesverbal për përgjimet që të ankohet i përgjuari. Kërkesa për përgjim bëhet sot, po sot jepet edhe vendimi nga gjykata. Të kufizohet si fenomen." Ndërsa për arrestin ai tha se duhet të zbatohet garancia pasurore. Ndërsa Spahiu ndërhyri e shtoi se pezullimi i funksionit për shpërdorim detyre është një masë më e pranueshme. Raqi Ceta i avokatisë së Korçës shtoi para nënkryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë problemin se ka edhe avokatë që venë direkt nga kafja e në seancë gjyqësore. Në Korçë, tha ai, janë dy apo tre avokatë që marrin çështje penale, jo se këta janë më të mirët, por të tjerëve nuk u jepen.

Më pas gjykata e vazhdoi analizën pa praninë e mediave.

Pëllumb Çuni

Spitalet dhe maternitetet drejt mekanizmit të ri të vetëmenaxhimit

Intervistë me zotin Refki Pere, shefi i repartit të obstetrikë-gjinekologjisë në Maternitetin e Pogradecit



-Sa kohë keni që punoni si obsteter-gjinekolog në maternitetin e Pogradecit?

-Kam 15 vjet që punoj si obstetër-gjinekolog në këtë maternitet, aktualisht që prej një viti jam shef i shërbimit.

-Sa është numri i lindjeve që kryhen në maternitetin tuaj dhe sa është vdekshmëria foshnjore?

-Në maternitetin tonë për vitin e kaluar janë kryer 737 lindje, nga këto 173 janë lindje me operacion dhe 564 janë lindje normale, pra e vlerësuar në përqindje 77% janë lindje natyrale dhe 23% lindje me prerje cezariane. Kemi 4 vdekje tek fëmijët 0-6 ditë, kryesisht janë fëmijë të lindur para kohe dhe nën peshë (hipotrofe).

-Si është numrit i lindjeve normale dhe operacioneve duke e krahasuar me vitet e kaluara?

-Si në të gjithë republikën dhe tek ne numri i lindjeve është në rënie, rreth 100 më pak se viti i kaluar. Numri i lindjeve me operacion është lehtësisht në rritje, kjo për arsye se është rritur shkalla e përgjegjësisë profesionale dhe qëllimi është që të lindin fëmijë pa probleme shëndetësore sepse qeliza e shoqërisë fillon tek ne.

-Si është raporti i lindjeve me abortet dhe cilat janë shkaqet që detyrojnë gratë të abortojnë? A ka aborte në minorene?

-Pavarësisht nga futja në përdorim e kontraktivëve të ndryshëm, një në tre lindje abortohen. Shkaqet që e drejtojnë gruan për të abortuar janë shkaqe ekonomike, mjerisht në numër të pakët ka dhe minorene që abortojnë.

-Sa futesh në hyrje të bën përshlyetje recepsioni që keni ngritur. Cili është qëllimi i tij?

-Kemi rreth një vit që kemi ngritur sistemin e recepsionit. Të gjitha pacientet që janë pa librezë shëndetësore janë të detyruara të bëjnë një pagesë për ekzaminimet dhe ndërhyrjet që kryejnë. Kjo ka patur si qëllim që të rritet numri i pacienteve të siguruara, rezultatet e të cilave ndihen sivjet ku numri i pacienteve të siguruara është rritur.

-Kemi dëgjuar një vendim të qeverisë që spitalet dhe maternitetet do kalojnë në varësi të institutit të sigurimeve shëndetësore.

-Po, kjo është e vërtetë. Në muajin mars ana ekonomike do menaxhohet nga ky institut. Spitaleve u jepet më shumë pavarësi që të ardhurat detyësore që ato mbledhin të vetëmenaxhohen nëpërmjet një bordi që ato do të ngrenë. Ministria e shëndetësisë do të caktojë protokollet për çdo ndërhyrje dhe sëmundje me një fjalë pacientet e pasiguruara do të paguajnë për operacionet, lindjet, shtrimet ekzaminimet ekografike dhe laboratorike që ato do të kryejnë. Të ardhurat që do të grumbullohen, do të përdoren si të ardhura detyësore për personelin shëndetësor duke bërë të ligjshme paratë që ata marrin dhe duke i prerë rrugën korrupsionit në mjekësi, efekti i së cilës do të ndihet pas 2-3 vitesh ku dhe pagat e personelit do të rriten.

-Kemi dëgjuar që në maternitet lindin fëmijë ilegalë, të cilët më vonë braktisen nga nënat. A ka pasur raste të tilla në maternitetin tuaj?

-Mjerisht edhe tek ne ekziston ky fenomen. Në këto vitet e fundit ka

pasur rreth 3-4 raste të tilla. Pacientet vijnë, lindin, japin identitet të rremë dhe i braktisin foshnjat duke i lënë në maternitet. Në një rast falë bashkëpunimit me organet e rendit dhe organet e pushtetit lokal në arritëm të identifikojmë prindërit dhe fëmija tani është në gjirin e familjes.

-Keni patur raste me kancer të qafës së mitrës, kancer të gjirit dhe fëmijë të lindur me Hiv Aids?

-Kemi patur raste me kancer të qafës së mitrës dhe gjirit, të kapura në stadi të vonshme terminale inoperabel kur sëmundja ka depërtuar në gjak, ndërsa fëmijë të lindur nga gra me Hiv nuk kemi. Kanceri i qafës së mitrës është një sëmundje që zhvillohet ngadalë në terren të një lezioni të mëparshëm prekanceroz të patrajtuar. Shkaktari i kancerit të qafës së mitrës tashmë është izoluar dhe është një human papiloma virus. Janë rreth 20 tipe të këtij virusi, por vetëm 2 tipe, tipi

mund të parandalohet sepse dihet që në mjekësi është më lehtë të parandalosh se sa të mjekosh. Për ta kapur këtë sëmundje në stadi të hershme rekomandohen dy procedura të thjeshta që quhen Pap test dhe kolposkopia, të cilat së shpejti edhe tek ne do të futen si ekzaminime rutinë dhe më e mira e kësaj pune do të ishte që shteti t'i subvenciononte dhe t'i bënte ekzaminimet e detyruara dhe falas. Aktualisht është zbuluar vaksina për këtë sëmundje dhe firma farmaceutike Glakso e ka futur në Shqipëri me një çmim rreth 500 euro. Ajo duhet aplikuar në tre doza në vajzat 10-12 vjeçare. Ideale do të ishte që kjo vaksinë të subvencionohej nga shteti dhe të aplikohet falas si të gjitha vaksinat e tjera. Në Amerikë kjo vaksinë i aplikohet fëmijës së seksit femër në dy doza, doza e parë aplikohet që në ditët e para të lindjes dhe doza e dytë në moshën 18 vjeç.

-Si i keni kushtet në maternitet dhe a janë bërë investime? Si është niveli i pajisjeve dhe i furnizimeve me ilaçe?

-Për fat të keq investimet janë të pakta, pasi ekziston një masterplan për centralizimin e të gjitha shërbimeve mjekësore në një vend afër spitalit ekzistues duke bërë rikonstrukcionin e spitalit infektiv dhe kthimin e tij në maternitet. Për fat të keq fondet e miratuara nga qeveria janë të pakta. Duke i dhënë prioritet spitalit rajonal të Korçës mos harrojmë që Pogradeci është qytet turistik, ku numri i popullsisë është në rritje nga migrimet e banorëve nga rrethet e tjera dhe nga dyfishimi i popullatës në kohën e verës. Ekziston një disnivel ndërmjet zhvillimit urban që ka marrë kohët e fundit qyteti dhe zhvillimit të mjekësisë.

i 16 dhe 18 kanë rrezik të lartë kancerogjen. Kjo sëmundje njihet si sëmundje seksualisht e transmetueshme. Kanceri i qafës së mitrës zë vend të parë ndër kancerat në sistemin riprodhues të grave në vendet e zhvilluara. Në këto vende diagnostikohen rreth 510.000 raste të reja në vit dhe vdesin rreth 300.000 gra në vit me këtë diagnozë. Ky kancer

-Ju faleminderit!

Intervistoi: **Esat Berberi**

Kostaq Duka, SHBA

Kush mori pjesë në mbrëmjen e artit, organizuar nga stafi i revistës "Rreth Nesh" në bashkëpunim me Aleancën Shqiptare Amerikane, më 2 nëntor të vitit të kaluar, padyshim ka fiksuar në kujtesë momentet që u sollën nga filmimet e kryera gjatë provave për vënien në skenë të komedisë së Spiro Çomorës "Karnavalet e Korçës".

Duke përcjellë këto momente aktori i Teatrit Kombëtar të Shqipërisë, Pandi Siku, një nga promotorët e fuqishëm të lëvizjes artistike në gjirin e emigrantëve të Çikagos u shpreh "Mirë se të vini në shfaqjen e komedisë "Karnavalet e Korçës", në janar në Çikago. Ne ju presim, ne kemi nevojë për pjesëmarrjen tuaj..."

Dhe ja më 25 janar, pjesëmarrja e gjërë e spektatorëve në sallën e teatrit, mbi pesëqind vetë, çka i jepte mjedisit më shumë ngrohtësi e gjallëri ishte reflektim i dukshëm, i kulturuar, ndaj kësaj ftese nga bota e artistëve. Ideja se "Karnavalet e Korçës" e Spiro Çomorës, një nga kryeveprat e komedisë shqiptare, e cila për mesazhet njerëzore që bart, me vlera të tilla universale që kohrat s'i zvetënojnë, ka gjithnjë raporte të ngrohta me spektatorin, po vinte pak si ndryshe me një risi në Çikago lindi e u afirmua plotësisht.

"Karnavalet e Korçës" e Spiro Çomorës ka mbi 50 vjet jetë. Si në komeditë e Karaxhales dhe Eftimiut ajo sjell pjesë jete që s'i përkasin një momenti të dhënë, por që kanë thekse të vërteta do të thosha alarmante, aktuale. Pikërisht theksimi aktual, krijon mundësi të pafundme për gjetje të reja regjisoriale aktorese."

Trupa e teatrit në përbërje ka aktorë që kanë mbaruar Akademinë e Arteve në Shqipëri dhe që kanë luajtur në skenat e Shqipërisë si Ilir Borova në rolin e Nikollaqit, Elvis Borova në rolin e Afrovitit, Pandi Siku në rolin e profesor Janit, Miola Sitaj në rolin e Aspasisë, aktorë të talentuar e me përvojë të gjatë edhe pse amatorë si Zhani Marko në rolin e Olimbisë, Arben Kamberi në rolin e Lonit, Pajazit Murtishi në rolin e prefektit dhe aktorë që guxuan të ngjiten në skenë për herë të parë, si Monika Marko në rolin e D itkës dhe Juliana Serritella në rolin e Konteshës.

Regjia ka ditur me profesionalizëm të përshtatë më së miri rolet me aftësitë dhe veçansitë aktorese duke krijuar një lojë me vlera artistike në ansambël.



Tingujt e ngrohtë, groteske, të muzikës së shkruar posaçërisht për këtë shfaqje nga kompozitori Eton Murtishi dhe dekori i thjeshtë, simbolik e tërheqës përgatitur nga Ilir Borova, ku binin në sy dy fustane gjigante, të vendosura si shtylla të portës, së përditshme e më tej të portës së fatit njerëzor, që në fillim e "mbërthyen" spektatorin.

"KARNAVALET e Korçës" në Çikago

Spektatorët, sidomos të moshës mbi 40 vjeç sigurisht e kishin të njohur fabulën e kësaj komedie, madje dhe shumë batuta nga ato që s'hiqen kurrë nga mendja rifreskoheshin të gjalla në ecuri e sipër. Këtë ndjesi provonin në veçanti, spektatorët emigrantë të ardhur në Çikago nga Korça, për të cilët janë të pashlyera mbresat nga shfaqjet e kësaj komedie nga teatri "A.Z.Çajupi" në Korçë. Ata patën "privilegjin" nëpërmjet tekstit të komedisë, lojës së aktorëve dhe muzikës të "shpërnguleshin" shpirtërisht tutje në rrugicat me kalldrëm, në pazarin e famshëm të Korçës, mes zakoneve të mbara e të mbrapshta, thashethemeve, zilive, falsitetit të njerëzve që duke pasur pasuri e katandi kujtojnë si Nikollaqi e Olimbia se janë elitë edhe e qytetarisë edhe e kulturës. Por pati dhe nga ata që sollën në kujtesë edhe suksesin e jashtëzakonshëm që kjo komedi ka pasur në skenën e Teatrit Kombëtar në vitin 1964 ku shkëlqeu në rolin e Olimbisë Artistja e Popullit, Violeta Manushi.

Nikollaqi i "Karnaveleve të Korçës" në Çikago, është jo vetëm skllav i parasë, i zvetënuar, i paskrupullt që edhe fatin e vajzës, martesën e saj e ve në ankand, por edhe paksa modern në të sjellë e gjepte, që përdor celular,

që i pëlqen seksi femër edhe pse përpigjet të fshihet prej Olimbisë. Aktori, Ilir Borova mjeshtërisht na solli një Nikollaq ku spikatin trajtime origjinale me theksim të groteskut. Ky rol është një nga më të spikaturit në krijimtarinë e tij artistike. Me të drejtë, në biseda për shfaqjen spektatorët shprehën: Iliri na befaso! Nikollaqi i tij ishte i veçantë dhe me vlera të vërteta artistike. Role të tilla, dëshmon historia e teatrit shqiptar kanë pasur emra nga më të shquarit.

Interpretimit me nivel të rolit të Nikollaqit nga Ilir Borova iu bashkangjiti po me kaq sukses aktorja Zhani Marko në rolin e Olimbisë. Fjala e përcjellë me qartësi dhe me nuanca groteske humori, mimika që nxitte natyrshëm të qeshurën dhe kalimi me finesë nga situatat komike të gëzimit fals.

E tërë intriga e komedisë "Karnavalet e Korçës" ka në thelb gjetjen e një burri, për vajzën e rritur të Nikollaq Jorgaxhiut, i cili në çdo hap ve si kusht paranë, del i fituar ose i humbur. Mëdyshjet e dilemat tragjike komike të tij kanë jehonë tek e shoqja Olimbia dhe vajza Afroviti. Por ai që vërtit mekanizmin e kësaj intrige nga fillimi në fund të shfaqjes është Loni. Aktori i talentuar Arben Kamberi që në shpalljen e intrigës e deri në fund, në zgjidhje të saj e mban gjallë

vemendjen e spektatorit. Humori i tij, në të folurit, shpesh belbëzak shoqëruar me gjepte groteske jo njëherë e bënë spektatorin të duartrokasë.

Në historinë e vënies në skenë gjatë 50 viteve të komedisë "Karnavalet e Korçës" një galeri të pasur kemi edhe për një personazh të spikatur komik siç është perfekti. Kush do ta luante këtë rol? Dhe ja regjia e vuri gishtin tek artisti amator, biznesmeni Pajazit Turmishi i famshëm për recitimet me pasion e zë të plotë, kumbues, të poemës "Bagëti e bujqësi" të Naim Frashërit. Spektatorët shikuan një prefekt injorant, me një të folur pa kulturë, agresiv ndaj dijes e përparimit, por edhe me vese morale, në sjelljen me femrat. Pajaziti jo vetëm u ngjiti me rolin, por u bë pjesë e suksesit në tërësi të trupës. Ngjijten për herë të parë në skenë përballuan me sukses dhe Monika Marko në rolin e D itkës dhe Juliana Serritella në rolin e Konteshës.

Merita më e madhe iu takon aktorëve e regjisorëve, por ata patën pranë edhe inkurajimin e ndihmën konkrete nga Aleanca Shqiptare Amerikane dhe stafi i revistës "Rreth nesh" e në veçanti nga biznesmeni Nick Vangel që dha ndihmë financiare dhe Tam Shubalis, i cili për disa muaj në mjediset e restaurant "Diplomat West" u krijoi mundësi aktorëve të bënin provat për këtë shfaqje.

Bukuria më e madhe qëndronte tek shqiptarët që jetonin bashkë me amerikanët

Si e preka Amerikën unë, minatori i Drenovës

Për 27 vjet pa ndërprerje Ali Çota punoi në minierën e Mborje-Drenovës si minator. Nga thellësitë e galerive të nëntokës shqiptare atij iu krijua mundësia që të shohë dhe grataçielat e Amerikës. E kishte patur ëndërr që të shkelte tokën e saj. Donte ta shihte me sytë e tij se nuk i mbushej mendja me ato që shikonte nëpër ekrane dhe lexonte nëpër gazeta. Por, përsëri dhe pse e ka shkelur dy herë Amerikën Ali Çota mbetet një minator prej Drenove dhe për këtë ndjehet krenar. Por njeriu nuk ngopet dot as me mrekulli thellësish, as me mrekulli lartësish.

-Sa herë keni qenë në Amerikë

-Dy herë ka shkuar Aliu e dy herë është kthyer. Tani jam edhe drenovar edhe minator edhe amerikan. Po bëra realitet një ëndërr që e kisha si çdo shqiptar. Nuk jam i pari që e kam prekur e shkelur Amerikën. As i fundit nuk do të jem unë.

-Si e bëtë realitet ëndrrën tuaj për të prekur Amerikën?


-Po, është e vërtetë që ëndrra ime u bë realitet. Pas viteve '90 kur u hapën kufijtë tanë si çdo shqiptar unë ëndërrova që të shkelja Amerikën, ose si vizitor i thjeshtë, ose si turist. Por edhe të emigroja për atje si shumë shqiptarë në shekuj dhe pas 90-ës që lanë vendin dhe gjetën strehë të re. Amerika në sytë e çdo shqiptari shihej si një vend me arritje të mëdha ekonomike dhe si një paradaj. Një vend me standarte të larta njerëzore. Aty njeriu është i lirë, gëzon të gjitha të drejtat për të punuar dhe jetuar të mbrojtura nga shteti. Isha kurioz që në jetën time të përpiqesha që këtë vend të largët dhe të hapur për shqiptarët ta shihja. Mundësia m'u dha me ligjin për bashkimin familjar. Së bashku me gruan fluturova drejt Amerikës. Atje na priste vajza së bashku me nipin dhe mbesat. Po vizitonim një shtet me shumë shtete.

-Si udhëtuat?

-Udhëtimin e bëmë me ajër, që përsëri ishte një shuarje kurioziteti tjetër për mua minatorin nga Drenova. Udhëtua për herë të parë me avion në lartësi dhe largësi të mëdha. Më dukej sikur retë më ndiqnin pas dhe më thoshin: "Ali, ku po shkon kështu."

-Me çfarë përshtypje e hodhët këmbën e parë në tokën amerikane?

-Kur mberritëm në shtetin Tennessee në qytetin Nashville, ndjeva një kënaqësi shpirtërore, e cila m'u shtua kur përqafova vajzën Nevila, nipin e vogël Xhebin, mbesat Rubin dhe Benitën, të cilat kishin dalë për të



na pritur dhe shuar mallin e njëri-tjetrit.

-Si i kaluat pushimet në Amerikë?

-Pushime të këndshme. Përveç vajzës ne na pritën dhe shqiptarë që jetonin në qytetin e Neshvillit. Ky qytet ishte i bukur, por bukuria më e madhe qëndronte tek shqiptarët që jetonin bashkë me amerikanët. Thosha me vete se këtu gjeta një shtet që mban në zemër jo vetëm dhimbjet dhe hallet e popullit të vet, por edhe të popujve të botës, edhe të Shqipërisë sonë, edhe të Drenovës me minatorët e saj.

-Po komuniteti shqiptar a ishte i organizuar apo...

-President i komunitetit ishte Beqir Potka. Më pyesnin për Shqipërinë dhe zhvillimet e saja gjatë këtyre viteve të demokracisë. Unë u jepja sqarime se tranzicioni po plakët e nuk po e shijojmë demokracinë si ju këtu në Amerikë. Rendiment të lartë kemi me partitë që shtohen për ditë. Shtohen partitë, shtohen hallet e shqiptarëve. Fëmijët i kemi në Amerikë, po Amerikën nuk e kemi ngritur në Shqipëri.

-U takuat me shumë shqiptarë?

-Në kujtesën time do të mbeten bisedat, takimet, mikpritjet e Selimit,

Në kujtesën time do të mbeten bisedat, takimet, mikpritjet e Selimit, Andonit, Nikos nga Kuçova, Dashamirit nga Berati, Fatmirit, Besnikut e Peros nga Korça, Mustafajt e Veros nga Durrësi, Pëllumbit e Vaskës nga Fieri, Leka Kapshticës e Ladit nga Korça, Tanit e Blerti Qoses nga Tirana, vëllezërit Eqerem, Pajtimt e Maksi Jaupit nga Qatromi i Korçës. Kishin mall për Shqipërinë tonë e më flisnin me respekt për Amerikën.

dëgjojnë për ngjarje konkrete. Ata kërkojnë të na vjelin, por edhe ne që vemi e vijmë duam që t'i vjelim.

-Do të shkoni përsëri?

-Tani e kemi të hapur rrugën, por një herë në vit na takon që të vemi. Por unë mbetem minator i Drenovës. Shkoj në Amerikë më kujtohet Drenova. Vij në Drenovë më ngrihet mendja për të ikur. Por ajo që dua të them është se mua m'u realizua dëshira dhe ëndrra prej vitesh për të shkelur paradajin e Amerikës. Nuk e them për patriotizëm, por shqiptari mbetet shqiptar. Unë kur shkoj në Amerikë bëhem më shqiptar. Kur vij këtu flas për Amerikën, po prapë shqiptar... Njohim edhe persona që e kanë lënë vendin prej vitesh e nuk kthehen. Madje edhe prindërit i kanë lënë në vetmi e nuk i marrin një herë në telefon. Shqiptarët e ikur herët e kanë shuar dhembshurinë për vendlindjen. Ata që kanë ikur pas viteve '90 e ruajnë ende. Një gjë më ka bërë përshtypje se fëmijët e atyre që kanë lindur nga ikja e re, flasin shqip se nënat e tyre ua mësojnë gjuhën. Ata të hershmit e kanë harruar dhe as që u shkon në mendje për të mësuar një fjalë të nënës së tyre.

Nga Afroviti Gusho

Para disa kohësh, në një rubrikë humori lexova:

Pabarazi

Një parlamentar anglez ka thënë: femra nuk është inferiore ndaj burrit, por as superiore ndaj tij, ndërsa për barazi nuk bëhet fjalë.

Me trishtoi, në fakt, kjo thënie, s'më bëri të qesh. Ndoshta është humor anglez, psherëtiva me vete. Por kjo më bëri të ulem e të shkruaj këto radhë...

Ndarja e pushtetit midis burrit dhe gruas është akoma shumë i pabarabartë. Ky ishte motivimi mbi të cilin u mbështet Këshilli i Evropës pesë vjet më parë, kur vuri theksin mbi një rekomandim të rëndësishëm. Komiteti i Ministrave ra dakort për të ndërmarrë veprime "për të balancuar pjesëmarrjen e burrave dhe grave në vendimmarrjen politike dhe publike". Ideja ishte që të hapej dera për gratë në pushtet.

Komiteti përcaktoi një kufi. Sipas tij pjesëmarrje e balancuar në organet vendimmarrëse, do të thoshte që prezantimi si i burrave ashtu dhe i grave nuk duhet të binte nën 40%. Vetëm dy shtete, Suedia dhe Finlanda, e kanë kaluar këtë nivel në parlament, kurse shtetet e tjera Skandinave, Austria, Belgjika, Gjermania, Holanda, dhe Spanja qëndrojnë shumë mbrapa. Në gjysmën e Evropës, prezantimi i gruas është nën 20% dhe 8 shtete e kanë më pak se 10% (Shqipëria, Armenia, Gjeorgjia, Malta, Monako, Rusia, Turqia dhe Ukraina).

Situata është e njëjtë edhe në qeveri. Tri shtete, vitet e fundit, kanë arritur një balancë të plotë 50-50, Austria, Spanja dhe Suedia, kurse disa qeveri nuk kanë pasur fare përfaqësues gra dhe mesatarja ka qenë nën 20%.

Këshilli i Evropës nuk bën përjashtim. Në Asamblenë Parlamentare jo më shumë se 26% e anëtarëve janë gra, dhe në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale shifra është 27%. Midis Ambasadorëve në Strasburg vetëm 13% janë gra, dhe midis 46 Ministrave të Jashtëm jo më shumë se 5 (11%) janë gra.

Kodi Zgjedhor në Shqipëri



Pabarazi

Një parlamentar anglez ka thënë: femra nuk është inferiore ndaj burrit, por as superiore ndaj tij, ndërsa për barazi nuk bëhet fjalë.

Të parat e klasës...

A kemi ne një model për gratë politike?

KUOTA

Kuota, vazhdon të mbetet një çështje mjaft e diskutueshme. Thuhet se vendosja e kuotës është një formë diskriminimi për të kualifikuarit. Një tjetër argument është se ata që favorizohen nga vendosja e kuotës mund të mos konsiderohen të aftë sa duhet pasi kanë marrë "ndihmë". Gjithashtu është parashtruar mendimi se vendosja e një kuote thjesht do të ruajë statu quo-në nëse nuk do të jetë ambicioz sa duhet.

Sigurisht, diskriminimi pozitiv mund të ketë edhe pasoja negative. Për këtë arsye duhet të përdoret vetëm kur ka një objektiv dhe justifikim të arsyeshëm. Ideja që mbështesim është e rëndësishme: të kompensohet një diskriminim negativ kaq thellë i rrënjësor, në mënyrë që të thyhen ato zakone dhe perceptime, të cilat përjetësojnë pabarazinë. Në të vërtetë, për mendimin tim, kuota gjinore mund të kontribuojë për të ndryshuar qëndrime dhe në

këtë mënyrë do të sjellë progres të mëtejshëm.

Detyrimi me ligj i kuotës është ende i pazakontë në Evropë, por është më e zakonshme që vende të ndryshme të provojnë variante të vendosjes së objektivit në mënyrë vullnetare. Në disa raste, thjesht kërcënimi i rregullave detyruese i ka nxitur partitë politike të rimendojnë procedurat e tyre të nominimit.

Duhet të ritheksojmë se pas gjithë këtyre diskutimeve pyetjes "A është e rëndësishme kuota?" do t'i përgjigjesha pa hezitim: **Po, shumë! Sepse:**

*Ka të bëjë me realizimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale për të gjithë.

*Ka të bëjë me demokracinë e vërtetë. Një shoqëri, ku gjysma e popullsisë është pak a shumë e përjashtuar nga pjesëmarrja në politikë, nuk është plotësisht demokratike.

*Është domosdoshmëri me qëllim që të shmanget humbja e resurseve të tjera intelektuale e njerëzore.

Të gjithë e dinë tashmë se kemi një Kod të ri Zgjedhor.

I parë nga këndvështrimi i barazisë gjinore ky është Kodi i parë i Republikës sonë që përfshin "kuotën e grave", aq shumë të diskutuar së fundmi nga aktorët e politikës, medias, shoqërisë civile, po ashtu është mbështetur fuqishëm nga ndërkombëtarët.

Ja çfarë thotë Neni 67 i Kodit zgjedhor:

5. Për çdo zonë zgjedhore të paktën tridhjetë përqind e listës shumëemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore një në çdo tre emra në listë duhet t'i përkasë secilës gjini.

Nëse do ta analizojmë me qetësi do të kuptojmë se në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, partitë do të vendosin nëse do t'i rreshtojnë gratë në fund të listave, nëse do të kenë një grua në tre vendet e para të listës e të tjerat përsëri në fund, apo në rastin më "fatlum" e gjithë lista do të jetë e alternuar 2 plus 1 nga secila gjini. Pra çdo gjë do të varet nga vullneti politik i partive.

Modelet

Sfida e radhës për gratë që do të "guxojnë" të hyjnë në garën e 2009, falë ose jo 30% të kuotës, do të jetë "Modeli i gruas politike". Edhe kjo është një temë shumë e diskutuar, si nga burrat edhe nga gratë. A kemi ne një model për gratë politike, nëse jo, a duhet të kemi, si duhet të jetë ky model? Gra të forta, gra të buta, gra si

burra, gra si kukulla, gra si...?!

Këtu më lejoni të bëj një parantezë. I keni pyetur fëmijët tuaj ndonjë ditë: Kush mëson më shumë në klasën tuaj? Kush është i pari i klasës? Dhe ndodh që shpesh të përgjigjen: Eshtë ajo, Mirela, apo Dorina, apo... dmth një vajzë. Askush nuk habitet. Askush nuk thotë pse një vajzë dhe jo një djalë është "i pari i klasës". Eshtë një gjë krejt e natyrshme. Në shkollat tona. Në Shqipëri.

Për çudi, këto vajza që kanë shkëlqyer në shkolla, kanë marrë medalje të arta kur kanë mbaruar gjimnazet dhe kanë mbaruar fakultetet nga më të vështirët..., një ditë nuk dëgjohej më.

Tavani prej xhami i pengon. (*)

vijon në faqen 9



Jam me ty!

Thirrja për ndihmë më detyroi t'i shtyj dorën, e cila ishte pak e hapur, pasi kishte dalë Beniku... Ai! Gjenden brenda... shtanga, pasi kuzhina ishte kthyer përmbys... Genta e shtrirë mes sendeve thërriste për ndihmë! Një curril gjaku i rridhte nga balli tek hunda e pikonte mbi buzët e zbehta... e ajo çuditërisht gëlltiste gjakun bashkë me lotët. Ju afrova, e ngrita pak... nuk dija ku ta vendosja, e nuk di a i gjeta fjalët që duheshin!

-Ti nuk e meriton të trajtohesh në këtë mënyrë...

Unë jam këtu me ty, mos u shqetëso... jam me ty!

Genta duke më parë në sy dëneste dhe fliste...

10 vjet që pres, prita me shpresën e madhe se do të ndryshojë, heshta se mendoja që çdo goditje, çdo tradhëti, çdo egërsi, inat, dhunë e histori do të ishte "hera e fundit". Papritur pamja e saj ndryshoi, fytyra i mori një ngjyrë të purpurt, sytë i ndritën, poshtërimi i dha forcë, durimi i dha krahë... ngriti telefonin (ia kisha dhënë unë).

-Doja të denoncoja një rast dhune fizike...

Nuk e di çfarë i thanë në anën tjetër të telefonit, por ajo heshti: Unë... unë jam e dhunuara, po, kam shënja, kam plagë... kam gjak, kam dhimbje fizike e shpirtërore...

-Po, po, rruga Rinia, pallati 26, ju lutem ejani sa të mos jetë vonë!

Pas 10 minutash u dëgjua makina e policisë. Ka kaluar gati një vit dhe Gentës të drejtën për të jetuar e lirë nuk mund t'ja merrte dot kush...

Iljon Kalija

"Gjergj Pekmezi" (viti IV)

S'do ta harroj të keqen që më bëri

Marina Pendavinji

Shkolla "Muharrem Çollaku"

Tani që jam ulur në këtë karrige, jam një e pandehur, e di që jam fajtores, e di edhe që kam kryer një krim... Jam e ndërgegjishme, e di që kam vrarë, e di që kam vrarë burrin tim... burrin që s'e pata kurrë burrë. Por më lejoni që edhe unë të them dy fjalë, besoj se e kam këtë të drejtë...

Pastaj më gjykoni si të doni dhe më dënoni sa të doni... U martova dhe unë si gjithë bota. Isha vajzë fshati, dhe kur më thanë që do martohesha në qytet, u gëzova. Por s'e dija që ditët që më prisnin ishin ditë të zeza... E keni provuar ndonjë

herë që të hani dru 3 herë në ditë. Ndoshta edhe mund të qeshni, por burri im keqdashës më bënte një dhuratë çdo vakt. Dhe kjo dhuratë ishte druri që unë merrja çdo ditë. Shikojini këto shënja, këto njolla. Besoj se deri sa të jetoj, s'kanë për të më ikur. Kjo këtu është shënja nga një togzë rripi, kurse kjo këtu është djegur nga një bisht cigareje, sepse shpesh herë m'i shuante mua në trup. Ndërsa kjo tjetra është nga një bisht thike, edhe pse në ato momente do preferoja më tepër thikën sesa bishtin e saj. Ju s'mund ta imagjinoni, ju të gjitha e prisni burrin tuaj që të kaloni një natë të qetë, kurse unë... unë prisja që të merrja dhuratën e



radhës. Unë e vrava, po, me këto duar, por e bëra për vetëmbrojtje sepse s'mund të lejoja që ai të më bënte keq. Më thoshte që isha një budallaçkë... Dhe ai s'e kuptonte që budallai në këtë shtëpi ishte ai, ai ishte një dhunues, por një dhunues i mbushur plot me pasion e dëshirë për të ushtruar profesionin e tij, dhunën. Edhe pse e kam vrarë s'jam penduar.

Sa dua që tani të jetë duke u djegur në flakët e ferrit. Por unë s'kam krahë që të fluturoj, për ta parë. Ju mund të thoni që unë jam

një e çmendur, jo, nuk jam... po vë dorën në zemër dhe po ju them që sa të jetoj, në sytë e mi do të jetë tmerrri, frika, dhuna, madje edhe në ëndrrat e mia. Sepse edhe pse e vrava dhe ai s'është më në këtë jetë, unë s'jam ngopur me hakmarrjen time. S'jam penduar kurrë e s'do të pendohem. Tani që i thashë ato që kisha brenda, më gjykoni dhe më dënoni drejt. Vendoseni ju në qoftë se jam e pafajshme apo jo... sepse edhe në qoftë se do ta fal një ditë, unë kurrë s'do ta harroj të keqen që më bëri, kurrë s'do ta harroj.

Çdo grua është një heroinë

Në jetën e një femre normale nuk ka mision të vështirë, për një femër nuk është mision i vështirë të qenit nënë, grua, bijë apo motër pasi një femër ia del në gjithçka. Si mund të realizohet kjo? Për ata që s'e kuptojnë është "Forca e femrës" që vepron. Por punët vështirësohen kur një femër dhunohet. Atëherë në sytë e asaj do të jetojë loti dhe vuajtja. Vuajtja se nuk mund të arrijë dot

fundin e atij tuneli pa dritë. Ajo do të jetë si të gjitha të tjerat pa zot, por të jetë zonja e vetes. Jeta nuk mund të jetë ashtu, por plot vuajtje, ajo duhet të arrijë fundin e tunelit, duhet të shikojë dritë, duhet të jetë ajo që ishte më parë. Ja ti nuk mundesh ta dhunosh, jo ti. Ti je shumë, shumë shkallë më poshtë se një femër, ti nuk e di çfarë është të qenit femër. Jeta për çdo femër është si një

trëndafil me shumë petale kur ti fillon të dhunosh një femër, këto petale fillojnë të bien nga nja sa herë ti, që e quan veten superior e të pathyeshëm ngre dorën mbi një femër, por prapë ajo është femër dhe ti e di se çdo femër, çdo nënë, çdo grua, çdo bijë e çdo motër është një heroinë. Secila në mënyrë e saj arrin të jetë mbi gjithçka dhe kur petalja e fundit e trëndafilit është në mëdyshje

të këputet ose jo atëherë dhe e gjakosur ajo arrin të të shpërfillë tashmë s'është më një viktimë e jotja dhe ty, ty të shumëzon me zero, po ajo ia arriti qëllimit, është ajo femër që ishte më parë. Për të gjithë meshkujt: Mbroni femrën, këtë mrekulli të perëndisë dhe falënderoni perëndinë që u lejoi syve tuaj të shihni këtë mrekulli.

Elisa Loska

Pse duhet të heshtësh?

...Kishte ditë që e shikoja të hynte në gjykatë. Më tërhiqte pamja e saj fisnike, vështrimi disi i përhumur e që mundohej të tregohej e qetë.

Seanca gjyqësore do të fillonte pas pak e unë nuk isha aty rastësisht.

Në korridor ecejaket e burrit më bënë ta shoh gjatë. Fytyra e tij dukej e egërsuar, por edhe e trembur, sytë vështronin kuturu, e një lloj krenarie e detyronte të shihte gruan dhe gjithçka përreth me mospërfillje.

-Çfarë kërkon? -i tha gjykatësi gruas -meqenëse ti ke bërë

kërkesë-padinë.

-Zgjidhjen e martesës, -tha ajo me një zë të mbytur.

-Me apo pa faj?

-Pa faj, -tha ajo, thua se është vetë fajtoare.

-Përse? -e pyeti gjykatësi, -ju në seancën e pajtimit, në mungesë të bashkëshortit kërkuat zgjidhjen e martesës me faj të tij.

-Pohove se këtë po e bëje për shkak të grindjeve, të rrahjeve të vazhdueshme?!

Gruaja i uli sytë edhe më... Thua maste me milimetra pllakat e dyshemesë. Unë vështrova burrin,

të cilit i lëvizte një e qeshur tallëse në fytyrë.

-Përse? Përse? -thashë unë, - papritur e pakujtuar duhet të heshtësh?

Edhe unë këtu, ai të dhunon? Fol, këtu të mbron ligji.

-Mos e prish rregullin, -m'u drejtua gjykatësi, -ndryshe gjobitesh! Fjalët e mia bënë një stuhi tek shpirti i gruas.

Tek largohesha, zëri i saj, forca, guximi pushtuan gjithë sallën, sytë e saj më shikonin me dashuri dhe gëzim...

Dorina Gjika



Të parat e klasës...

vijon nga faqja 7

Po rikthehem tek modelet. Shumë emisione televizive janë bërë së fundi për gratë/me gratë/ me gratë dhe burrat/ për të diskutuar pjesëmarrjen e gruas në politikë. Shumë nga emisionet reflektojnë emancipim, mendje të hapura si nga burrat dhe nga gratë. Por, në fund të ndonjë emisioni, kur ca gra që i pëlqen shumë publiku drejtuesja e emisionit i pyet: Po ti, do hysh në politikë, ato përgjigjen shkurt "Jo". Domethënë, modelet e grave që i pëlqen publiku, i thonë jo, përfshirjes në politikë. Kjo gjë më ka dëshpëruar.

Në një vizitë studimore në Kroaci, nëntorin e vitit të kaluar (2008) mësuam rreth eksperiencave të disa organizatave kroate, të cilat realizonin studime e botime për gruan, punonin për përfaqësimin e barabartë burrë-grua në politikë, ofronin trajnimin e grave në politikë etj. Ajo që u theksua në këto takime ishte fuqia e bashkëpunimit midis shoqatave dhe rëndësia e fushatave për më shumë gra në politikë. Thoni se çfarë lloj gruaje dëshironi. Zgjidhni modelin:

-ato gra, të cilat nuk do t'ju harrojnë

-ato, të cilat do të mbijetojnë

-ato, të cilat do të sillen si gra... ishin disa nga porositi e tyre.

Epilog

Fillim korriku 2009. Një mikja ime më ndalon në rrugë e më përshëndet. E more vesh, më pyet, Irlisa fitoi, do të jetë në Parlament.

Irlisa? Sa mirë!!! E njoh! Ka qenë e para e klasës...

(*) Barriera të padukshme që e pengojnë gruan të arrijë pozicione të larta drejtuese.

"Unë vlej, prandaj them stop"



ajo çka më vriste më shumë ishte keqardhja. Tërhiqesha zvarrë nëpër shtëpi me duart në kokë dhe pikëpyetje plot. Duhet të gjeja një zgjidhje. Fëmijët e mi nuk kishin nevojë për një nënë ashtu siç ai thoshte. Ata kishin nevojë për një nënë të nderuar nga të gjithë njerëzit, me personalitet dhe forcë brenda vetes. E si mund t'i ndihmoja unë fëmijët e mi kur nuk isha në gjendje të mbroja veten. Por s'ishin vetëm këto pikëpyetje. Të tjera pyetje plot më lodhin si ku të gjej punë në këtë vend ku s'ka punë? Si t'i ushqej fëmijët? T'i le? Po si t'i le? Me atë?

Boll tani, o grua se pyetjet s'kanë fund, provo se asnjëherë s'do të kuptosh sa vlen sa e zonja ti je.

Ishte kjo forcë që i thshë STOP vuajtjes sime, e cila mbaroi.

Njerëz si ai janë të pavlefshëm për një familje, për një të ardhme dhe për një shoqëri. Unë vlej. Kam forcën, kurajon, zotësinë, dashurinë për fëmijët e mi të cilëve kurrë s'do t'u mësoj të jenë të dobët, por vuajtjen time, do t'ua mësoj FORCË. Forcë drejt së ardhmes, për tu përballur me sfidat dhe Ky do të jetë rezultati i fitores sime.

Njerëz si ai do të zvarriten si zvarranikët pas mureve të larta, dhe e sigurt jam, për ta s'do ketë mëshirë as ligji dhe as Zoti.

Përgatiti: **Teuta Hoxha**

Juriste pranë studios Avokatore "Për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara" Forumi i Gruas Elbasan

Çdo ditë kalon dhe e çuditshmja është se si nuk më mund dot moralin, personalitetin. Unë jam tashmë në vend të parë dhe e rëndësishmja është se unë di të rradhis njerëzit dhe t'u tregoj kush jam unë. Ai nuk mundi dot të më helmojë shpirtin dhe çka është e rëndësishme "Unë tashmë jam Unë"

Dikur nuk të njihja, moj vete. Nuk dija ku shkoja, nuk dija ç'të bëja, nuk dija çfarë ndodhte, nuk dija..., por një gjë e dija dhe e dini çfarë ishte? Ishte ajo çka më thoshte ai.

Më thoshte s'ke pse punon zemër se të lodhen doçkat, ke fëmijët për të rritur dhe ato kanë kaq shumë nevojë për ty saqë besoj se një nënë e mirë nuk i le fëmijët vetëm dhe shkon pas idiotësirave të botës që na rrethon. Për ty unë jam gjithçka shpirt, buka, ajri dhe oksigjeni e sheh sa i ëmbël jam. Mos më provoko me kërkesa idiote se...e di çfarë, do të ndodhin gjëra të frikshme dhe unë s'dua të bëhem i frikshëm. S'ke pse të dalësh nga

shtëpia, të shohin sa e bukur je dhe këtë unë nuk e duroj. Ti mëson gënjeshtat që ndodhin jashtë dhe unë s'dua që ti të mos thuash më të vërtetën që unë them. Më kupto zemër jemi mirë kështu. Ti gatuan mirë zemër, hë pra çfarë ke bërë për drekë? Përse nuk flet çka ngjarë? Je bërë kryengritëse? Të kisha paralajmëruar, kështu jeni ju femrat hipokrite, të pabesa, ja pse keni nevojë për dajak çdo natë, pasi harron detyrat e tua. M'u bind pra dhe mos e zgjat!

Plagët në fytyrë dhe në trup më dhembnin shumë, por më shumë më dhembte shpirti. Fëmijët më shihnin si një dobësi pa personalitet dhe

“Dhuna ekziston, unë dua ta parandaloj atë”

Burrrat nënë hije lozin kuvendojnë

Kohë të vështira ka kaluar populli shqiptar, pesëqind vjet robëri prej turkut të asaj kohe nuk janë pak. Nga kjo robëri populli ynë mbeti mbrapa në çdo drejtim, në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit dhe Europës. Mbi të gjitha mbetën zakonet prapanike që akoma nuk janë zhdukur. Zakone të këqija në dëm të gruas. Nga këto zakone gruaja shqiptare trajtohej si shërbyese, ajo s'kish të drejtë për asgjë në familje, të shfaqte mendime, të bashkëbisedonte me burrin, madje nuk i thosh atij as emrin. Ngarkohej me dru, u lante këmbët pjestarëve të familjes. Burri kish të drejtë ta rrihte dhe ajo të mos bënte zë etj, etj. Kështu këto zakone u rënjosën dhe ekzistojnë dhe sot, jo në atë masë, por patriarkalizmi është i pranishëm.

Sidoqë në regjimin e kaluar u bënë disa përmirësime në jetën e gruas në emancipimin e saj, me anën e organizatave të grave që u ngritën nëpër fshatra dhe qytete ku luftoheshin këto zakone të këqija dhe gruaja sikur e mori veten. Por prapë në zona të thella ekziston patriarkalizmi, bile dhe në qytete, në individë të maskuar. Me ardhjen e demokracisë që të gjithë duan të jenë të lirë të bëjnë si të duan etj. Por jo në kurriz të tjetrit e sidomos në kurriz të gruas. Disa burra fanatikë, dembelë, pijanecë dhe të pandjeshëm e morën demokracinë mbrapsht dhe filluan dhunën ndaj grave. Me opinionin që gruaja është lesh-gjatë dhe mendjeshkurtër kurse burri është burrë, ata filluan keqtrajtimin e tyre dhe tani nuk kish kush t'i mbronte.

Raste të tilla ka shumë. Një grua nga një fshat e Kolonjës, e martuar, me pesë fëmijë, bën thirrje (nëpërmjet gazetës) për ndihmë se i shoqi ngaqë është dembel, nuk i ushqen dot fëmijët, e rreh përditë duke ia vënë fajin asaj që janë keq ekonomisht dhe ato të ardhura që kanë ai i pi.

Gruas i kanë vdekur prindërit dhe s'ka ku të vejë, prandaj bën thirrje për ndihmë nga kushdo. Nëpërmjet ekranit mësova se një grua tjetër me tre fëmijë (të trija vajza) e rrihte burri përnatë se vinte i pirë. Gruaja iku për një kohë tek prindërit e saj, por ai i vajti dhe duke premtuar që do silllej mirë, e mori prapë në shtëpi. Por prapë filloi zakonet. Atëherë gruaja nuk duroi më dhe pati guxim të bënte aktin e fundit duke u bërë kriminele, e vrau atë dhe tani ndodhet në burg me njëzet vjet heqje lirie. Akt



që nuk duhej ta bënte, por nuk durohej. Ja ku të shpie alkooli, dembelizmi dhe injoranca, por ç' taksirat fëmijët që mbetën pa prindër. Një rast tjetër që të habit: Një burrë e la gruaja sido që kish fëmijë, se e trajtonte keq. Më vonë ai gjeti një grua që i kish vdekur burri, pa fëmijë, dhe u martua. Në fillim shkonin mirë, se burri kish qenë kuadër dhe merrte vesh nga emancipimi. Me ardhjen e demokracisë si quadro që kish qenë, deshi të bëhej prapë i tillë. Vendosi të formonte një parti më vete dhe çdo natë e mbante gruan deri në orën 24:00 për të shkruar ose lexuar materiale politike (se vetë nuk shikonte mirë nga sytë) dhe e torturonte gruan. Kur gruaja e pa që s'kish të mbaruar, e kundërshtoi dhe atëherë filloi divergjencia. Filluan ofendimet dhe keqtrajtimet. Mbase nuk e firmosi dot partinë që ëndërronte, ia nxirrte inatin gruas duke e rrahur (se u bë me nerva) dhe duke e akuzuar se ti më ke nxjerrë sekretin, ti u thua kundërshtarëve të mi që të më luftojnë mua etj. Ja pra veç alkoolit ekziston dhe injoranca, ndërgegjja e sëmurë.

Një grua nga fshati ish shtruar në maternitet bashkë me një tjetër nga qyteti. Në kushtet e spitalit i ishin bërë leshrat palarë mbase i kishte dhe të gjata. I thotë kjo e qytetit: Po t'i kishe flokët më të shkurtra, lahen më kollaj

dhe ndoshta do dukesh më e mirë. Ah moj motër, sa qejf kam unë t'i pres, por nuk më le burri, po i preve të vras, më thotë. Ja fanatizmi dhe injoranca ku ka arritur. Jam dakord që një burrë ka qejf ta ketë gruan me leshra të gjata, një tjetër e do me gërsheta, por jo me detyrim, por me konsultim burrë e grua e të vendosin.

Ja dhe një zakon shumë i keq: Në një krahinë e kanë zakon që kur vete burri me gruan gjëkund, në vend të ecin përkrah njëri-tjetrit dhe të bisedojnë rrugës problemet që kanë, burri ecën 7-8 metra para gruas, se kështu e do zakoni. Të paktën në këtë rast s'ka dhunim. Një shok ishte me pushime në Himarë, në një familje që kishte një vresht disi larg shtëpisë; erdhi fjala për transportimin e rrushit nga vreshti në shtëpi. O fare kollaj, tha i zoti i shtëpisë, ja ku është gruaja dhe brenda ditës rrushi vjen në shtëpi. Ajo krahinë e ka zakon që gratë ngarkohen dhe sot dhe nuk e kanë për gjë, kurse burrat bëjnë punë të lehta. Përnjëherësh m'u kujtuan fjalët e Çajupit: Burrat nënë hije lozin kuvendojnë, pika që s'u bie se nga gratë rrojnë. Në vitin 1955 u bë regjistrimi i popullsisë. Unë isha ushtar në Berat. Për mungesë nëpunësish na caktuan me tre shokë në një fshat ku na pritën shumë mirë. Në mbrëmje na caktuan në një familje për të fjetur. Kur na vjen nusja e shtëpisë me legen në dorë për të na

larë këmbët! Ne s'pranuam në asnjë mënyrë, se jo vetëm që bënim punë politike çdo ditë, po nusja ishte mosha jonë dhe nuk ishte e drejtë të na lante këmbët. Kjo që një mënyrë luftimi e zakoneve prapanike. Veç këtyre ka dhe luftë me kulturë po rrallë. Një shok me arsim të lartë ishte martuar me një grua dhe kalonin shumë mirë, kishin dhe dy fëmijë që tashti ishin të rritur. Dilnin xhiro çdo mbrëmje, fëmijët mësonin shumë dhe ishin të lumtur. Mirëpo nuk që e thënë të vazhdonte kjo lumturi.

Gruaja e tradhëtonte. Mbase u sigurua që ajo e tradhëtonte, një mbrëmje duke bërë xhiro si çdo natë u kthyen në një pasticeri ku hëngrën nga një pastë dhe kur dolën në rrugë jashtë pasticerisë burri i thotë: Tani ti nuk je më gruaja ime, vazhdo rrugën që ke nisur. Ajo nuk foli fare. Edhe fëmijët shkuan me të atin, i cili kish dhe të ëmën në shtëpi dhe jeta vazhdonte. Sikur burri ta vriste, çfarë do fitonte? Shkatërrimin e familjes, si ajo gruaja që vrau burrin. Fanatizmi dhe injoranca ekzistojnë, si rrjedhim dhe zakonet prapanike bashkë me dhunën, të cilat i paguan gruaja. Prandaj na bie për detyrë t'i luftojmë. Tani nuk ka organizatë që të kritikohen, të dënohen etj. këto zakone.

Mendoj për burrat që i keqtrajtojnë gratë, që përdorin dhunë, të influencojë familja në radhë të parë pastaj dhe farefisi i burrit dhe i gruas. T'ia venë në dukje të metat në mënyrë rigorozë dhe ai të japë fjalën e burrit. Po kështu dhe shoqëria ka mundësi të kontribuojë.

Për pijanecët është më e vështirë se ata bëjnë autokritikë me fjalët më të bukura dhe të nesërmen prapë vazhdojnë zakonet, nuk kanë besë. Për këta mendoj të krijohet një vend rehabilitimi siç ka qenë shkolla e rehabilitimit të adoleshentëve, nënkuptohet ata më ekstremët, në mënyrë që jo vetëm të mos ushtrojnë dhunë karshi grave, po të mos harxhojnë dhe ato të ardhura që ka familja, që dhe gruaja shqiptare të jetë si ajo europiane.

Rapi Meçi, pensionist



Tri vija formonin damarë. Një, uji i rrëmbyeshëm i Lepencit. Pastaj, rruga hekurudhore që na solli në këtë ferr dhe rruga sipër që për ne ishte mollë e ndaluar. Përtej lumit fillonte Sharri.



10 vjet më parë Toka shqiptare

Po afrohej muzgu i shtatë në kampin e Bllacës. Shtatë muzgje sa shtatë shekuj. Tre shekujt e parë me shi... shi... shi i ftohtë. Aty ku fillonte Gryka e Kaçanikut.

Tri vija formonin damarë. Një, uji i rrëmbyeshëm i Lepencit. Pastaj, rruga hekurudhore që na solli në këtë ferr dhe rruga sipër që për ne ishte mollë e ndaluar. Përtej lumit fillonte Sharri. Përtej rrugës Mali i zi i Shkupit.

Dhe ne po bënim një jetë të zezë. Jetë sterrë. Njëqind mijë. Një masë klithmash, vuajtjesh e pritjeje. Me lot. Me të qara fëmijësh e pleqsh. Ditët si njëra, si tjetra.

Ankth. Një ankth i pashpjeguar. Nuk dimë ç'presim. Nuk dimë ku do të vemi. As forcë nuk kemi të dimë më shumë. Fëmijë që kërkojnë prindërit. Prindër që kërkojnë fëmijët.

E mua, fëmijët më ishin shndërruar në numra. E pyes gruan a janë të gjithë pranë. Nuk i besoj. Dhe zë e numëroj: një... dy... tre... katër... pesë! se ata tani janë numra. Sikur nuk ua di emrat. Se ata janë



numra.

Pa nëna? Ku është nëna? Ajo është shtatëdhjetë e tre vjeçe. Me tension të lartë. Me bronkopneumoni. Me marramendje. Për krahu e ke, më thotë gruaja. Po motra? Aty e ke. Nuk më bëjnë sytë. As koka s'më punon.

Urdhri është i prerë. Të zbrazet kampi. Kampi i përqëndrimit në dymijëvjetorin e krishtërimin! Po, po! Në dymijëvjetorin e krishtërimin. Dhe aty afër, afër vendit ku lindi

Shenjtoresha e njerëzimit: Nënë Tereza. Gonxhe Bojaxhiu. Shqiptarja e Shkupit.

Por Shkupi është tepër larg. Më larg se Kalkuta. Më larg se tërë India. Më larg se Golgota. Më larg se nata e Shën Bartolemeut. Urdhri është i prerë. Të zbrazet kampi i Bllacës. Është muzgu i shtatë. I 6 prillit. Ç'natë ogurzezë. Po ku do të na shpien? Në ç'kamp do të vemi? A do të munden të na mbajnë këmbët...? Dhe presim... e ecim

ngadalë. Mezi mundemi të kalojmë tytat, ushtarakët, policët. E një vendi gjoja neutral... Shumë gjëra i duhen lënë historisë. Koka nuk më bën për mejtime të tilla. Shtatë ditë vetëm një herë bukë. Vetëm shi e diell. Shi natën. Diell ditën. Dhe pritje. Pritje e pafund... S'është ëndërr. Ne ecim. Kolona e autobusëve mbushet sa ora. Prapë numëroj për të disatën herë. Ndoshta për të mijtën herë. Një... dy... tre... katër... pesë. Çudi! Pesë. Grua? Po! Nënë? Po! Motër? Po! Dhe njëqind mijë të tjerë? Po! Shqiptarë? Po! E dini ku shkojmë? Jo! Një jo që të rrënoqeth kokë e këmbë. Që të plandos përdhe.

Kolona e autobusëve zë e ec. Po, për besë! Zë e ec! Vargu i pafund përpara. Vargu i pafund mbrapa. Vetëm në ndonjë kthesë do ta vësh këtë. E kthesa shumë. Po nga po vëmë? Asnjë përgjigje.

Nata e 6-7 Prillit. Ogur i zi? Ogur i bardhë? Rrugën e njoh. Nuk kthejmë për Tetovë. Ecim drejt Velesit. Nga po shkojmë? Në Turqi? Jo, o zot! Në Greqi? Nuk më besohet! Kthesa e kthesa. Kolona merr drejtimin e Manastirit. Është pasmesnatë. Tani filloi 7 Prilli. Vetëm 6 Prill jo. 7 Prill bën. Mbase një ogur i bardhë. Pastaj Resnja. Pastaj Ohri. Ah, Ohri. Dhe një pikëpyetje e madhe. Mos ka farë kampi mes Ohri e Prespe?

vijon në faqen 12



10 vjet më parë Toka shqiptare

vijon nga faqja 11

Po nata akoma nuk i bën udhë agimit. Qënka i madh ky Ohri. Si s' dalim njëherë tutje.

Gjumi më tradhëton. Është më tepër dremitje. Ankth. Rafale automatikësh. Deportim. Trokullimë therëse rrotash treni. Udhë e gjatë e refugjatit pa atdhe. Hap sytë. Nata sa s'është dorëzuar. Dremis. Kampi. Bllacë. Një javë pranë varrezave të fshatit. Tenda të improvizuara mbi varre. Njerëz të gjallë mbi varre. Të gjallët u lakmojnë të vdekurve. Nuk është dremitje. I kisha parë vetë këto skena mëse një herë.

Njerëz. Qindra njerëz. Skelete të gjallë lart. Skelete poshtë.

Kthesa më shpëton nga ankthi. Hap sytë e lodhur. Të stërlodhur. Kolona ndalon në Shën Naum. Kalon Drilonin. Ku vemi? Endërr? Jo, zhgjiëndërr. Agimi. Agimi do edhe pakëz. Me agimin do të dihen të gjitha. Dremis. Më zgjon një zë gruaje. Është nëna e gëzuar e fëmijëve të mi. Dashuria ime e parë

dhe e fundit.

Zgjoju, jemi në Shqipëri! Nuk më besohet. Shqipëria, them. Shqipëria, thotë. Kush e di se çfarë ëndërrojnë fëmijët. Nëna. Motra. Kolona. Lodhja është e tmerrshme. E mund edhe gëzimin e befasueshëm. A ka kuptim gëzimi pas atij ferri. Pas gjithë atij vaji fëmijësh, ku mungonte vetëm Moisiu të quhej udhëtimi biblik. Edhe pa Moisiun ai ishte i tillë. Mileniume e mileniume më pas. Si s'paska ndërruar bota? A thua dremis? Para mënxyrës njerëzore s'ka se si të jetë ndryshe veç dremitje. Kolona e mudi edhe errësirën. Ngadalë agu zbulon peizazh atdheu: Shqipëria! 7 Prilli 1999. Rrethinat e Korçës! Korça! Djepi i kulturës shqiptare. Mësonjëtorja e Parë. Shkolla e parë e vashave. Motrat Qiriazit. Lëndina e Lotëve. Ndalemi fare pranë Lëndinës së Lotëve. Janë lot gëzimi se jemi në Shqipëri, në Korçë. Se përpara na pret vetë Skënderbeu. Monumenti është i menduar. Si

gjithherë kur atdheu, kur kombi i qe në rrezik këtij heroi.

Është vesa e mëngjesit apo... jo mbase më bëjnë sytë... monumenti qan. Qan Skënderbeu? Tek sheh kolonën e refugjatëve... A jemi ne refugjatë... në tokën mëmë. Në një pjesë të tokës mëmë... Hymë në stadiumin "Skënderbeu" të Korçës.

Në tribunë asnjë spektator. Pos engjëjve të qiellit. Dhe policëve të rrallë që flasin shqip. Që sillen ëmbël. Një gjë e rrallë për ne. Një kënaqësi e përjetuar ndonjëherë. Fusha e gjelbër na i çlodh sytë. Na prehen eshtrat. Dhe vijnë pastaj të rinj e të reja. Mikpritje korçare. Shuajmë etje e uri... dhe dy misionare të Nënës Terezë. Edhe vetë Nëna Terezë. A thua dremis... dikush ma ledhaton ballin. Më përqafo. Është gruaja. Janë fëmijët. Dhe një fjalë që del nga secila gojë: si duket shpëtuam! Sa e ëmbël je, tokë shqiptare!

Abdullah Zeneli

(Fragment nga libri "Toka shqiptare")

Afroviti Gusho

Aromë lirie

Ku jeni
Miqtë e mi
Të Kosovës

Dua t'ju dërgoj
Një letër
Malli

Po e shkruaj
Pak
E nga pak
Çdo ditë

Ku jeni?

Erdhët befas
Duke fshirë
Kufijtë
Duke derdhur
Lotë ikje
Lotë humbjeje
prej shpirti

Ngatërrohem
në kujtimet
që i latë
në copëza letre
në faqe
të hapura gazete

Ngatërrohem
me tinguj telefoni
Mesazhe interneti

Pengohe
Në hijet
Që lanë
Pas
Litarët
Që tendosnin
Çadrat

Klithmat e fëmijëve
Me sytë
Në fluturimet qiellore

Erdhët befas
Dhe ikët po ashtu
Sapo ndjetë
Aromë lirie
Përzier
Me flakët
Që digjnin
Shtëpitë
E braktisura

Ikët...
Duke lënë pas
Një mjegull
Malli

Unë po ju nis
Një letër shprese
Mbi zarfin
E bardhë
Mundohem të shkruaj
Adresën:
Miqve të mi
Në
Tokën
Shqiptare



Libra të botuar gjatë vitit 2008




Autori	Titulli i librit	ISBN
○ Pëllumb Çuni	Tym dhe brirë fjalësh	(ISBN 978-99956-618-5-4)
○ Hajder Lilo	Konti i Monte Krabës	(ISBN 978-99956-618-6-1)
○ Mitat Lushnjari	Kujtesë e largët	(ISBN 978-99956-618-7-8)
○ Maliq Torra	Djeg ky mall	(ISBN 978-99956-618-8-5)
○ Edmond Zaçe	Vdekje e dembelosur	(ISBN 978-99956-672-1-4)
○ Maksut Çallo	Dehje Poradecare	(ISBN 978-99956-618-9-2)
○ Edmond Shallvari	Diku, dikë, dikush	(ISBN 978-99956-672-3-8)
○ Jorgji Rrushi	Veteranë	(ISBN 978-99956-672-5-2)
○ Petro Prifti	Mendime për mendimet, Unë ti	(ISBN 978-99956-672-4-5)
○ Rajda Petrela	Leshmanjoza viscerale	(ISBN 978-99956-672-2-1)
○ Pirro Piqoni	Antologji Përmbledhje poezish	(ISBN 978-99956-672-0-7)
○ P.Çuni, F.Biraku	Shamia e mbrëmjes	(ISBN 978-99956-672-6-9)
○ Agim Bacelli	Një kauboj në New York	(ISBN 978-99956-672-8-3)
○ Ziko Kapurani	Valixhja	(ISBN 978-99956-672-9-0)
○ Anastas Kostandini	Paris 07	(ISBN 978-99956-672-7-6)
○ Grup autorësh	Rebelim poetik	(ISBN 978-99956-705-2-8)
○ Bujar Braho	Brenda qënies së adoleshencës	(ISBN 978-99956-705-7-3)
○ Vangjush Ziko	Borëbardha flokëthinjur	(ISBN 978-99956-705-1-1)
○ Ilo Kotelli	Për ty Dishnicë	(ISBN 978-99956-705-3-5)
○ Agim Bacelli	Në çarku e puthjeve	(ISBN 978-99956-705-6-6)
○ Edmond Shallvari	Ç'u bëme kështu	(ISBN 978-99956-705-4-2)
○ Arjan Kallço	Qyteti nuk u përgjigj	(ISBN 978-99956-705-5-9)
○ Pavlina Kristo	Imazhi i jetës	(ISBN 978-99956-705-0-4)
○ Ramadan Dinoshi	Krua i mërguar	(ISBN 978-99956-705-8-0)
○ Paskal Zota	Drithërimat e Zemrës	(ISBN 978-99956-705-9-7)


Libra të rinj të Sh.B. "D.I.J.A - Poradeci"




Fjala magjike
Tregime dhe përralla për fëmijë
Autor: Sokrat Sheperi
Faqe 96
Çmimi: 300 lekë



Drithërimat e zemrës
Poezi dhe Ese
Autor: Paskal P. Zoto
Faqe 64
Çmimi: 250 lekë



Pritje e gjatë
Roman
Autor: Pavlina Kristo
Faqe 184
Çmimi: 300 lekë



Krua i mërguar
Poezi
Autor: Ramadan Dinoshi
Faqe 80
Çmimi: 300 lekë

vijon nga numri i kaluar

Profesor arkitekt Kristo Sotiri, një pogradecar i panjohur

Duke qenë inxhinier ndërtimi, arkitekt dhe skulptor dmth i gjithanshëm në ndërtim, ai ka patur si busull këto parime: çdo ndërtim duhet të jetë funksional dhe estetik, të harmonizohet me ndërtesat fqinjë, të ruajë traditën e qytetit, të jetë në funksion të planit urbanistik dhe t'i rezistojë kohës.

Ja veprat e tij:

- Restauron Kishën e Santa Maria della Salute (Shën Maria e Shëndetit) në qytetin e Venecias.

- Projekton ndërtimet e stabilimentit të Madh të Banjave në Lidon e Venecias (me konkurs).

- Projektoi ndërtesat e Ossariumit në Lidon e Venecias.

- Projektoi pallatin e Borsas në Gjenova (me konkurs)

- Projektoi pallatin e Madh della Kupole në Gjenova.

-Projektoi pallatin e Madh della Kornice në Gjenova.

- Projektoi kinema, teatër në Gjenova.

- Projektoi Ossarium në Kostanca (Rumani) me konkurs.

- Projektoi stabiliment banjash "Kasino" në Kostanca (Rumani)

- Projektoi xhami otomane në Kostancë.

- Projektoi Bankë otomane në Kajro (Egjipt)

Në vitin 1909 arkitekt Sotiri nga Italia kthehet në Rumani. Veprat:

Përmendorja "Avantul Tarii" kushtuar një ngjarje historike, dhe një bllok prej katër banesash, në një rrugë kryesore të Kostancës.

Monumenti kushtuar Jon Benesku, personalitet rumun, në Kostancë.

Në Shqipëri kryen këto vepra:

-Në Tiranë: Ndërtesa e Z.Abdi Toptani (projekt i vitit 1920), ndërtesa e ish-Bibliotekës Kombëtare në Rrugën e Elbasanit, pallati i princeshave (projekt 1938) Bashkia e kryeqytetit (projekt) stacion treni (projekt) vilë personale (projekt).

-Në Korçë: Projekti i Kishës së Vllehëve dhe plani i ndërtimit të Kishës së Mitropolisë.

-Objekte të tjera në Durrës, Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë.

Vangjo Llakmani

KESHILLA TE MJEKUT

Inkontinenca urinare

Inkontinenca urinare është njëkohësisht edhe sëmundje, edhe pasojë e sëmundjeve të tjera, që krijon shumë probleme dhe me një kosto jo të vogël, si për pacientin, ashtu edhe për familjen e tij dhe për sistemin shëndetësor. Me inkontinencë urinare do të kuptojmë mospërmbajtjen e urinës, për t'u derdhur më pas në mënyrë të vullnetshme. Shumë njerëz, por për fat të keq edhe disa mjekë e konsiderojnë këtë gjendje si normale dhe të pashmangshme për të moshuarit dhe se nuk kanë çfarë t'i bëjnë.

Ky është mendim i gabuar, pasi siç do ta shohim edhe më poshtë inkontinenca urinare nuk është sëmundje në vetvete, por një pasojë e disa sëmundjeve të tjera. Për këtë arsye, në qoftë se ne mjekojmë me korrektësi këto sëmundje, nuk do të ketë edhe inkontinencën. Nga ana tjetër do të kuptojmë se ekziston dhe mundësia e parandalimit të këtyre sëmundjeve e për pasojë dhe e inkontinencës urinare. Po ashtu nuk duhet të shmangemi para kësaj gjendjeje, pasi jo vetëm ka kosto të madhe financiare, por edhe një kosto psikologjike për të sëmurin.

Kur i moshuari vë re se nuk e mban dot urinën, fillon e mbyllet në shtëpi, mbyllet në vetvete, nuk tregon ç' i ka ndodhur, i krijohet një stres permanent, më pas mund të shkaktohen infeksione urinare e të lëkurës etj. Krijohet kështu një rreth i mbyllur, ku sëmundja që e ka shkakuar dhe vetë inkontinenca rëndohen përherë e më shumë, deri në atë masë, sa mund të jetë shumë e vështirë për t'u trajtuar.

Përsa i përket përqindjes së përhapjes së kësaj gjendjeje, mund të themi se nuk i kursen të dy sekset, por me një predispozicion më të lartë për femrat. Pra konstatohet në 15-30 për qind tek meshkujt dhe 20-55 për qind tek femrat, me një tendencë në rritje me rritjen e moshës. Faktorët përgjegjës për këtë gjendje ndahen në faktorë predispozues dhe faktorë shpërthyes ose që e shkaktojnë këtë gjendje.

Në faktorët predispozues



renditim: moshë mbi 75 vjeç, eneurezis nokturna apo urinimi natën në fëmijëri, ekzistenca e personave të tjerë në familje me këtë gjendje, e thënë më thjesht predispozicioni familjar, individë që kanë bërë një jetë sedentare, pa aktivitet apo ushtrime fizike, të moshuar që kanë vështirësi të ndryshme për të shkuar në banjë, qëndrimi i detyruar në shtrat etj.

Përsa i përket shkaktarëve, i ndajmë në katër kategori: 1.ata të urgjencës; 2.ata që shkaktojnë stres të aparatit urinar; 3.ata që shkaktojnë mbimbushje të vezikës urinare; 4.funksionalët.

1.Në kategorinë e parë renditen: rastet kur ekziston një dëshirë e papërmbajtur idiopatike për urinim të menjëhershëm; vezikë urinare e irrituar apo hipertoniqe; infeksione të rrugëve të poshtme urinare; infeksionet atrofikë të organeve genitale tek femrat; prezenca e gurit në vezikën urinare; tumor i vezikës urinare; insulti cerebral, parkinsoni, demenca senile, alkooli etj.

2.Në kategorinë e dytë renditen: lindjet e shumta, sidomos ato që shoqërohen me laceracione dhe qepje; operacione të tjera të regionit të legenit; trauma të tjera të po këtij regionit; deficit ose mosfunksionim i mirë i sfinterave që mbyllin rrugët e poshtme urinare.

3.Në kategorinë e tretë renditen: ngushtime me prejardhje të ndryshme të rrugëve të poshtme urinare; adenoma e prostatës apo kancera të ndonjë organi tjetër aty

afër; ngecje të fekaleve apo kapsllëk i tejzgatur; vezikë urinare atoniqe; dëmtime të kolonës vertebrale; medikamente si antipsikolitikët, antidepressivët, opiatet, sedativët; gjendja e depresionit, e deliriumi; prezenca e kateterit permanent.

4.Në kategorinë e katërt renditen: çrregullimet që shoqërohen me prodhim të tepërt të urinës, si me prejardhje nga hipofiza, diabeti etj.

Pra siç mund të merret me mend, mjekim tipik për inkontinencën urinare nuk ka, megjithë që ekzistojnë ushtrime dhe fizioterapi për forcimin e dyshemesë muskulare të legenit. Por këto rezervohen për moshë relativisht më të reja dhe kur inkontinenca është kapur në fazat e para. Kuptohet, duke mjekuar sëmundjen bazë që e ka shkakuar, duke i qëndruar pranë nga ana psikologjike të moshuarit, duke i krijuar lehtësitë e nevojshme për të shkuar në banjë, duke bërë një jetë aktive dhe pa neglizhuar të ushtruarit e fiskulturës apo të sporteve të ndryshme, duke evituar barrat e shumta apo abortet etj. patjetër që nuk do ta kemi problem këtë gjendje jo të këndshme. Në rastet ekstreme do të na vijë në ndihmë kateteri i thjeshtë apo ai permanent, por duhet treguar shumë kujdes për të mos shkakuar infeksione të herëpashërshme.

Dr.Andrea Kocaqi

Mjek familjeje, Libonik, Korçë

Horoskopi javor i "Nositit"



Dashi (21.3-20.4)

Do të keni disa probleme të paparashikuara, megjithatë do të përfitoni nga mundësitë e çastit.



Peshorja (24.9-22.10)

Do t'ju duhet të impenjoheni në një aktivitet që do të kërkojë shumë para dhe punë. Mos hezitoni.



Demi (21.4-20.5)

Mund të keni një ftesë nga një i njohur për të kaluar disa çaste me të, ose një ofertë për vend pune.



Akrepi (23.10-22.11)

Disa persona të rinj do të hyjnë papritur në jetën tuaj dhe do t'i keni pjesë të pandashme të aktivitetit.



Binjakët (21.5-21.6)

Nuk do të jetë e udhës që idetë tuaja për një projekt të ri t'ia tregoni dikujt që mund t'i përdorë.



Shigjetari (23.11-22.12)

Duhet të tregoheni më tolerant me kolegët tuaj, duke mos kërkuar gjëra që nuk janë në dorën e tyre.



Gaforrja (22.6-22.7)

Megjithëse ju shqetësojnë disa probleme, argëtimi dhe humori mund t'ju ndihmojnë të lehtësoheni.



Bricjapi (23.12-20.1)

Gjatë javës do të keni shumë takime pune që do t'ju lodhin, por do të mbeten të kënaqur.



Luani (23.7-23.8)

Një person do t'ju propozojë që të filloni bashkërisht një aktivitet fitimprurës të panjohur për ju.



Ujori (21.1-19.2)

Do të takoni në një vend dhe në një moment të papërshtatshëm një person të rëndësishëm për ju.



Virgjëresha (24.8-23.9)

Eshtë momenti t'u tregoni të tjerëve aftësitë tuaja. Mos mendoni se do t'ju ndihmojnë përherë.



Peshqit (20.2-20.03)

Ju duhet të tregoheni të qetë dhe do të arrini që çdo gjë të zgjidhet me sukses të plotë.

POEZI

Bora në Tiranë



Reiden Basho

Kolegji "Kristal", Tiranë


Tek po rrija në dritare,
Isha i çuditur fare.
Jam në ëndërr apo zgjuar?
Pyesja veten i menduar.

Po, po, zgjuar isha,
Dhe sytë hapur i kisha,
Nuk ish ëndërr, por realitet,
Bora e bardhë binte vërtet.
Flokë, flokë, lehtë-lehtë,
Shtroi një qilim të zbehtë.
Atë mbrëmje e zbukuroi,
Kur qilimin e bardhë shtroi.

Oh, sa shumë u gëzova,
dhe me vrap jashtë dola.
Preka borën me gëzim,
Duke luajtur me rrëmbim.

Vipat Top Sekret

Beckham merr me qera vilën e Clooney-t



David Beckham sapo ka marrë me qera një vilë tek Clooney. Futbollisti milanez ka marrë me qera vilën luksoze në Landro, mbi liqenin e Como-s. Lajmi u bë publik nga revista "People". Futbollisti, që aktualisht ndodhet me Milanon dal Galaxy të Los Angeles, ka marrë me qera vilën ku deritani ka jetuar si mysafir. Clooney dhe futbollisti u njohën vitin e kaluar në New York, në një ballo gala në Metropolitan Museum. Së bashku i prezantoi stilisti Giorgio Armani.

Bebe në familjen Del Piero

Lajmi u dha nga vetë kapiteni i Juventusit përmes një lajmi deklaruar në sitin e tij të internetit.



Alessandro Del Piero dhe gruaja e tij Sonia janë në pritje të fëmijës së dytë. "Jemi të lumtur të ndajmë me të gjithë ju këtë gëzim. Sonia është në pritje të fëmijës së dytë pas lindjes së Tobia", thuhet në deklaratë. "E ndjejmë se duhet ta ndajmë me të gjithë këtë lajm".

Rihanna feston vetëm ditëlindjen

Pas agresionit që pësoi nga i fejuari i saj Chris Brown, Rihanna ka vendosur të qëndrojë vetëm në ditën e 21-vjetorit të lindjes. Ajo që kaloi këngëtarja mund të quhet një "e premtë e zezë", që kaloi



vetëm për të harruar më tepër sesa për të festuar, megjithëse me këtë rast kishte ftuar miq dhe të afërme. Lajmi u dha nga "Sunday

Mirror", duke nënvizuar se stari, nëse nuk do të ishte rrahur në mënyrë çnjerëzore do ta kishte festuar ditëlindjen me një mega party në New York, sepse ndjehej e fortë dhe e lumtur, ashtu siç kishte deklaruar dhe vetë pak para se të ndodhte agresioni.

1	2		3	4	5	6		7	8		9	10	11	12	
13			14						15	16					17
	18	19													
20									21			22			
	23			24						25					
	26								27					28	
29					30		31				32		33		
34									35	36				37	
38			39		40				41					42	
		43		44				45					46		
47	48									49	50		51	52	
53				54		55		56			57				
	58					59								60	

KREDI PËR SHTEPI

Ku do të rriten ata nesër, ju e vendosni sot.

B.T.H. + 0%*
Duke filluar nga Libor € + 4.75%

*Për dy vitet e para, më pas duke filluar nga B.T.H. + 2%

www.bpopullore.com

BANKA POPULLORE
SOCIETE GENERALE GROUP

Së bashku për të ardhmen

Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 456)

Horizontalisht: 1.Tomorri 5.SK 7.Ko 9.BRA 11.Aga 12.Birmania 13.Karakumi 16.Po 17.Kau 19.Moska 21.Amurdarja 22.Aris 24.IK 25.Io 26.IK 27.Mi 28.Kabuli 30.Re 32.Al 34.IT 36.As 37.VL 38.Argoni 40.Roma 43.Berna 46.Dhima 48.Neon 49.E gje 50.Diamanti 52.LU 53.Sina 56.Bri 57.Lartë 58.II 59.Martin 63.Ari 64.Kosta 65.Leon

Vertikalisht: 1.Tasmania 2.OG 3.Maksim 4.Rëra 5.Simaku 6.Krim 7.Kapri 8.Andora 9.Bakri 10.Akua 12.BU 14.Aksi 15.Ko 18.Ajka 20.Or 23.Aksident 24.Iberik 29.Iva 31.Elena 33.Luani 35.Tregu 36.AN 39.Odesa 41.Om 42.Madrid 44.Renato 45.Not 47.Da 49.Elba 51.II 54.IRA 55.AEK 56.Bis 57.Li 60.Al 61.Re 62.In

Horizontalisht: 1.Quhet skuadra e futbollit e Fierit 7.Pepino... Kapri 9.Diana..., qitëse 13.Notë muzikore 14.SHBA 15.Silvestër..., aktor 18.Maja më e lartë në Afrikë 20.Atdheu i Alendes 21.Unë kam, ti... 22.Ana..., këngëtare greke 23.Po në Romë 24.Uji i ngurtë 25.Vëllezërit..., shkrimtarë anglezë 26.Gjysmë tape 27.Burreli në targa 28.Dy shkronjat e para 29.Kryeqyteti i Spanjës 31.Roman i Sterjo Spasses 33.Materje gri 34.Aktorja italiane Manjani 35.Kryeqyteti i Letonisë 37.Tirana në targa 38.Emër kinezi 39.Qytet në Marok 42.Lloj aeroplani rus 44.Humoristi anglez Hill 45.Degë e lumit Vollga 46.Inicialet e këngëtarit Alibali 47.Ka katër dhoma 49.Hekuri për kimistët 51.Inicialet e Tolstoit 53. ...Boletini 54.Berati në targa 55.Ho Shi... 57. "... bijë njeriu", roman i Martin Andersen Nekse 58.Vullkan në Itali 59.Mal në vendin tonë 60.Letër bixhozi

Vertikalisht: 1.Emri i Kapones 2.Ka kryeqytet Islamabad 3."... i vocërr" i Migjenit 4.Kosit pa skajet 5.Hoti i Partisë Ekologjike 6.Aktori Shvarencener 8.Fizikani Njuton 9. ...Ce Dun 10.Aktori Paçino 11.Këngëtarja Tërshana 12.Inicialet e Nevskit 16. ...i Përbashkët Evropian 17.Kryeqyteti i Skocisë 19.Poemë e Homerit 22.Mund të jetë edhe i brishtë 24.Kryeqyteti i Etiopisë 27.Kryeqyteti i Zvicrës 28.Kinematografia është... i shtatë 29.Qytet në rrethin e Korçës 30.Këngëtarja italiane Spanja 31.Atdheu i Shopenit 32.Quhej komandanti i jeniçerëve osmanë 36.Inicialet e Kadaresë 40.Lidhëse 41.Me ta bëhet taka 42.Ka kryeqytet Valeta 43. ...Pashë Toptani 48.Lidhëse 50.Aktorja Luarasi 52.Inter..., agjencia ruse e lajmeve 55.Targa e Mirditës 56.Inicialet e Mandelës

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Në kompjuter: Edlir PODA
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
redaksianositi@yahoo.com